Vendim nr. 83, datë 22.09.2026

(V- 83/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 22.09.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (M) 2025, që u përket:

KËRKUES: **MYRSHIT VORPSI,** përfaqësuar nga avokati Agron Aliaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Engjëll Agaçi.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Kledia Ngjela.

BASHKIA E TIRANËS, përfaqësuar nga nënkryetarja Anuela Ristani.

BEQIR FETISHAJ, MINTOSH FETISHAJ, ËNGJËLLUSHE BURRELI, ARIAN FETISHAJ, SELADIN FETISHAJ dhe ZYRA FETISHAJ, përfaqësuar nga avokati Sabri Karaj, me prokurë.

GËZIM FETISHAJ, XHEMILE FETISHAJ, LINDITA KALLUSHI, DALLËNDYSHE LATIFI, LIRI KOLECI, përfaqësuar nga Ëngjëllushe Burreli, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1975 (86-2024-2151), datë 19.11.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-2375, datë 03.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Myrshit Vorpsi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bashkisë së Tiranës, Beqir Fetishaj, Mintosh Fetishaj, Ëngjëllushe Burreli, Xhemile Fetishaj, Lindita Kallushi, Liri Koleci, Dallëndyshe Latifi, Gëzim Fetishaj, Seladin Fetishaj, Arian Fetishaj dhe Zyra Fetishaj, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, anëtar i familjes (Vorpsi) Petrela, sipas vërtetimit hipotekar nr. 227, datë 18.04.2007, është bashkëpronar edhe i pasurisë së paluajtshme të llojit "truall", me nr. 6/136, me sipërfaqe 31.222 m², në rrugën "Skënder Kosturi", Tiranë. Kjo pasuri është fituar me vendimin nr. 1091, datë 28.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (*vendimi nr. 1091/1994 i KKKP-së, Tiranë*) me të cilin subjektit të shpronësuar A.P. (trashëgimtarëve të tij, ndër të cilët edhe kërkuesi) i është njohur e drejta e pronësisë për sipërfaqen 120.000 m^2, nga e cila i është kthyer fizikisht sipërfaqja 23.522 m^2, ndërsa për sipërfaqen 96.487 m^2 i është njohur e drejta e kompensimit. Nga ana tjetër, anëtarët e familjes Fetishaj kanë pretenduar se një pjesë e pasurisë së tyre mbivendoset me sipërfaqen prej 439 m² të njohur familjes Vorpsi/Petrela, çështje për të cilën janë zhvilluar disa procese gjyqësore, të evidentuara në vijim të vendimit.

2. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 752, datë 05.09.2013 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i

projektit "Bulevardi verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës – Faza e I-ë në Bashkinë e Tiranës"" *(VKM-ja nr. 752/2013),* ka shpronësuar për interes publik kërkuesin, bashkëpronarët Fetishaj dhe familjet Burreli, Kallushi dhe Koleci për sipërfaqen 3137.5 m^2, pjesë e pasurisë nr. 6/136, me sipërfaqe të përgjithshme 31.222 m^2, kundrejt vlerës 26.137 lekë/m^2, pra në total 82.004.838 lekë. Në bazë të këtij vendimi është vendosur shpronësimi i subjektit A.F. (trashëgimtarët ligjorë të të cilit janë subjektet e interesuara Arian Fetishaj, Seladin Fetishaj dhe Zyra Fetishaj) për një sipërfaqe 60.8 m^2, pjesë e pasurisë nr. 7/155, me sipërfaqe të përgjithshme 260 m^2, kundrejt vlerës 26.137 lekë/m^2, pra në total për vlerën 1.589.130 lekë. Po kështu, VKM-ja ka disponuar shpronësimin e bashkëpronarëve të familjeve Fetishaj dhe Burreli për një sipërfaqe prej 165.3 m^2, pjesë e pasurisë nr. 7/156, me sipërfaqe të përgjithshme 212 m^2, kundrejt vlerës 26.137 lekë/m^2, pra në total për vlerën 4.320.446 lekë.

Procesi i parë gjyqësor për kundërshtimin e VKM-së nr. 752/2013

3. Me padinë e datës 04.11.2013, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar detyrimin e Beqir Fetishaj ta njohë pronar (trashëgimtarët në bashkëpronësi) për sipërfaqen 647 m^2, sipas vendimit nr. 1091/1994 të KKKP-së, Tiranë, ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 752/2013 lidhur me përcaktimin e subjektit të shpronësuar për pasurinë nr. 228, datë 18.04.2007, duke njohur pronar kërkuesin, ndryshimin e pjesshëm të këtij akti lidhur me masën e shpërblimit të caktuar për shpronësim për sipërfaqen e shpronësuar 280 m^2 dhe detyrimin e të paditurve, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Bashkisë së Tiranës, për të paguar shpërblimin për shpronësim në bazë të çmimit të tregut.

4. Me vendimin nr. 2518, datë 21.02.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarimin e moskompetencës lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e saj për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në seancën përgatitore të datës 30.06.2014 përpara gjykatës administrative, kërkuesi ka hequr dorë nga kërkimi i objektit të padisë për detyrimin e të paditurit Beqir Fetishaj për njohjen pronar për sipërfaqen 647 m^2. Për rrjedhojë, me vendim të po asaj date, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin e parë të objektit të padisë. Për pjesën e mbetur të kërkimeve të padisë, që kishin të bënin me ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 752/2013, me vendimin nr. 5352, datë 02.10.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e tyre, duke vlerësuar se kërkuesi nuk kishte legjitimitet aktiv për ngritjen e kësaj padie, pasi nuk rezultonte të ishte pronar i pasurisë së shpronësuar me VKM-në 752/2013. Sipas asaj gjykate, nga vlerësimi i

provave të dosjes gjyqësore dhe që i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, nuk rezulton që në momentin e ngritjes së padisë kërkuesi të ishte pronar i pasurisë së shpronësuar, e cila rezulton t'i jetë shpronësuar shtetasit Beqir Fetishaj dhe rezulton e regjistruar në emër të këtij të fundit. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 07.11.2014, pasi nuk është ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

Procesi gjyqësor për njohjen pronar

5. Me padinë e datës 25.02.2014 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar detyrimin e Beqir Fetishaj ta njohë pronar dhe t'i kthejë pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe 647 m^2, që ndodhet në qytetin e Tiranës, mbështetur në vendimin nr. 1091/1994 të KKKP-së, Tiranë. Me vendimin nr. 9031, datë 22.09.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar palën e paditur, familjen Fetishaj, të njohë pronar dhe t'i kthejë paditësit (kërkuesit) sipërfaqen e truallit prej 439 m^2, ZK 8330, që ndodhet në qytetin e Tiranës, mbështetur në vendimin nr. 1091/1994 të KKKP-së (sipas hartës përkatëse). Për pjesën tjetër të pasurisë prej 208 m^2, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë.

6. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 2158, datë 03.11.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, e ka zgjidhur drejt mosmarrëveshjen e parashtruar përpara saj. Kurse me vendimin nr. 00-2024-268, datë 10.01.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material dhe se ato gjykata kanë bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e kanë zgjidhur drejt mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke u dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve dhe prapësimeve të palëve.

Procesi i dytë gjyqësor për kundërshtimin e VKM-së nr. 752/2013 (objekt i ankimit kushtetues)

7. Bazuar në këto vendime të gjykatës civile, kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës administrative me padi kundërdrejtuar Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Bashkisë së Tiranës, me objekt ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 752/2013 për sa i përket rrethit të subjekteve në favor të të cilave është kryer shpronësimi dhe

konkretisht nga bashkëpronarët Fetishaj, Burreli, Kallushi, Koleci etj. në favor të kërkuesit Myshit Vorpsi në bashkëpronësi në pasurinë nr. 7/156, ZK 8830, për sipërfaqen 149.3 m^2, në vlerën 3.902.253 lekë dhe nga Arif Fetishaj në favor të kërkuesit në bashkëpronësi në pasurinë nr. 7/155, ZK 8830, për sipërfaqen 60.8 m^2, në vlerën 1.589.130 lekë. Sipas kërkuesit, shpërblimi i shpronësimit për këto pasuri i takon familjes Petrela si pronare e tyre.

8. Me vendimin nr. 5751 (5772), datë 01.12.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e padisë si të bazuar në ligj dhe në prova, duke ndryshuar VKM-në nr. 752/2013 për sa i përket subjektit në favor të të cilit duhet dhënë shpërblimi i shpronësimit për sipërfaqen 60,8 m^2, pasuri e cila ndodhet në pasurinë nr. 7/155, ZK 8330 dhe për sipërfaqen 149,3 m^2, pasuri e cila ndodhet në pasurinë nr. 7/156, ZK 8330, në favor të familjes Petrela. Sipas asaj gjykate, shpronësimi duhet të bëhej ndaj pronarëve të pasurisë së paluajtshme dhe shpërblimi i shpronësimit u takonte pronarëve të pronës, që sipas vendimit nr. 9031, datë 22.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 2158, datë 03.11.2015 nga Gjykata e Apelit Tiranë, rezulton se janë bashkëpronarët e familjes Petrela për pasurinë 439 m^2. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur në procesin gjyqësor, Ministria e Punëve të Brendshme, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit, si dhe personat e tretë, familja Fetishaj, të cilët kanë kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes.

9. Me vendimin nr. 1975 (86-2024-2151), datë 19.11.2024, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit, duke arsyetuar se e njëjta çështje ishte shqyrtuar një herë nga ajo gjykatë dhe se padia ishte paraqitur përtej afateve ligjore. Sipas asaj gjykate, në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë, nga historiku i kësaj çështjeje, vërtetohej se kërkuesi kishte marrë dijeni për aktin e kundërshtuar (VKM-në nr. 752/2013) që në vitin 2014 kur i ishte drejtuar me padi fillimisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe minimalisht që në muajin shkurt të atij viti, ndërkohë që nuk vërtetohej asnjë shkak ligjor për pezullimin e afatit të së drejtës për të kundërshtuar aktin gjyqësisht. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka konstatuar, kryesisht, se padia ishte ngritur jashtë afateve ligjore.

10. Po sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë ka pasur mundësinë objektive të konstatojë se çështja administrative ishte e njëjtë në lëndë, shkak dhe kërkim me atë të paraqitur edhe më parë nga kërkuesi, për të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ishte shprehur me vendimin nr. 5352, datë 02.10.2014. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, referuar palëve ndërgjyqëse, objektit të padisë, shkakut ligjor të saj, kërkimeve të shqyrtuara dhe të vendosura në gjykimin e mëparshëm, ajo ndodhej përpara "*gjësë së gjykuar*", gjë që e pengonte për të shqyrtuar sërish këtë çështje. Gjykata e apelit ka arsyetuar se gjykata e shkallës

së parë, në interpretim të gabuar të ligjit, ka vazhduar të shqyrtojë padinë objekt gjykimi si padi të re dhe ka disponuar për themelin e saj, ndërkohë që pretendimet e kërkuesit nuk përbënin shkaqe për ngritjen e një padie të re. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

11. Me vendimin nr. 00-2025-2375, datë 03.06.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012*), të cilat mund ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

12. Me kërkesën e datës 01.10.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 07.10.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 15.12.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

13. Në datën 18.09.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve, në zbatim të neneve 36 dhe 37 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

14.1. *E drejta për proces të rregullt*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

14.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial dhe së drejtës për t'u njoftuar,* pasi kërkuesi nuk është njoftuar nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit në datën 03.06.2025. Pretendimet e ngritura në rekurs, që kishin të bëjnë me të drejtën e pronës private, ishin të tilla që nuk mund të vlerësoheshin në dhomën e këshillimit në fazën e shqyrtimit paraprak.

14.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj,* pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë zgjidhje shkaqeve të rekursit, megjithëse është kërkuar edhe njësimi i praktikës për këtë situatë atipike kur shpërblimi për interes publik i jepet subjektit jopronar.

14.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar se përse është parashkruar e drejta e ngritjes së

padisë dhe, për më tepër, nuk i janë referuar asnjë dispozite konkrete ligjore që shpjegon se kur fillon dhe kur mbaron afati i parashkrimit të kësaj padie ose cilat janë dispozitat ligjore të zbatueshme. Ato gjykata nuk kanë arsyetuar as përse është konsideruar "*gjë e gjykuar*" çështja e kërkuesit kur nuk bëhet fjalë për një vendim me të njëjtat palë, objekt, shkak dhe fakte dhe as nëse konsiderohet "*gjë e gjykuar*" një vendim që nuk e ka zgjidhur çështjen në themel. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar se përse kërkuesi është trajtuar si subjekt i shpronësuar, në një kohë që ai nuk ishte në listën e subjekteve të shpronësuara, pasi pasuria e tij mbivendosej me një pjesë të pronës së subjekteve që rezultonin në listën e subjekteve të shpronësuara. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse të drejtën e shpërblimit të pasurisë së shpronësuar të kërkuesit e kanë përfituar subjekte të tjera jopronare dhe përse ky përfitim i padrejtë i tyre nuk mund t'i kthehet pronarit të ligjshëm nëpërmjet zëvendësimit të subjekteve të shpronësuara. Ajo gjykatë nuk mund të shqyrtonte pretendimet për të drejtën e pronës në dhomën e këshillimit në fazën e shqyrtimit paraprak.

14.2. *E drejta e pronës private,* pasi si pasojë e vendimeve të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë ka mbetur në fuqi situata juridike sipas së cilës shpërblimi për pjesën e pasurisë që kërkuesi pretendon se i përket atij si pronar u është njohur subjekteve të tjera.

15. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave****,* ka prapësuar si vijon:

15.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial dhe të së drejtës për t'u njoftuar* është i pabazuar, pasi kërkuesi ka pasur detyrimin që të ndiqte shpalljet e Gjykatës së Lartë për të marrë dijeni për datën e seancës së shqyrtimit paraprak të çështjes së tij në dhomën e këshillimit. Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me parashikimet procedurale të nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) dhe është kompetencë e kolegjit në dhomën e këshillimit të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Kërkuesi, edhe pse ka barrën e provës, nuk ka arritur të provojë në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit.

15.2. Pretendimet për *cenimin e parimit të gjykatës së paanshme dhe gjykatës së caktuar me ligj* janë të pabazuara. Kërkuesi nuk ka parashtruar argumente të mjaftueshme në kuptim të testit subjektiv dhe testit objektiv të vlerësimit

kushtetues të parimit të paanshmërisë. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka tejkaluar kompetencat dhe kufijtë gjatë shqyrtimit të rekursit lidhur me zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta, por ka vepruar brenda kompetencave të saj.

15.3. Pretendimi për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit*, është i pabazuar, pasi pretendimet e kërkuesit dhe argumentet e parashtruara, në thelb, kanë të bëjë me interpretimin e ligjit, i cili nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues. Vendimi i gjykatës së apelit dhe ai i Gjykatës së Lartë kanë përmbushur standardet kushtetuese të arsyetimit dhe në tërësinë e tyre paraqiten të rregullta në formë, si dhe nuk rezultojnë të kenë paqartësi në përmbajtje. Pjesët hyrëse, ato arsyetuese dhe dispozitivët e vendimeve objekt gjykimi janë në unitet dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Po kështu, arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese për këto lloj vendimesh.

15.4. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar në kushtet kur kërkuesi nuk ka provuar ekzistencën e një ndërhyrjeje arbitrare ose joproporcionale në të drejtën e pronës së tij.

16. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Punëve të Brendshme,*** ka prapësuar si vijon:

16.1. Argumentet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt* janë të paarsyeshme dhe të pabazuara, pasi kjo ministri, në cilësinë e ministrisë së linjës, sipas nenit 10 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" (*ligji nr. 8561/1999*), ka administruar kërkesën e Bashkisë së Tiranës, ka ngritur komisionin e shpronësimit dhe ka ndjekur të gjitha fazat procedurale të parashikuara në ligj. Identifikimi i pasurive të shpronësuara është bazuar në të dhënat zyrtare të institucioneve shtetërore kompetente, përfshirë Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZRPP*), sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Për më tepër, e gjithë procedura e shpronësimit, e finalizuar me VKM, ka qenë objekt kontrolli gjyqësor dhe nuk është konstatuar asnjë shkelje e ligjit material ose procedural. Pronarët mund të paraqesin padi dhe të kundërshtojnë VKM-në për vlerën e shpronësimit, ndërkohë që çdo pretendim tjetër që lidhet me mosmarrëveshjet mes pronarëve ose subjekteve që kanë të drejta pronësie nuk zgjidhet me padi ndaj institucioneve shtetërore.

17. ***Subjekti i interesuar, Bashkia e Tiranës,*** ka prapësuar se:

17.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial dhe të së drejtës për t'u njoftuar* është i pabazuar, pasi neni 480 i KPC-së nuk parashikon njoftimin e

palëve, por se shqyrtimi i rekursit bëhet brenda 60 ditëve nga depozitimi, pa praninë e palëve, pasi janë shqyrtuar pretendimet me shkrim të tyre për çështjen e pranueshmërisë. Gjykata e apelit me të drejtë ka konstatuar se kërkuesi ka qenë në tejkalim të afatit 30-ditor, referuar nenit 24 të ligjit nr. 8561/1999 dhe, po ashtu, se për të njëjtin objekt kërkesëpadie dhe të njëjtat palë ka pasur një vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (vendim nr. 5352, datë 02.10.2014), i cili ka marrë formë të prerë, duke u ndodhur kështu në kushtet e "*gjësë së gjykuar*".

18. ***Subjektet e interesuara, anëtarë të familjes Fetishaj*,** kanë prapësuar:

18.1. Pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi ai nuk ka kundërshtuar asnjëherë origjinën e pasurisë së familjes Fetishaj, konkretisht kontratën e shitblerjes me anë të së cilës ata janë bërë pronarë të pasurisë që në vitin 1953. Padia e ngritur nga kërkuesi është për njohjen dhe dorëzimin e pasurisë nga familja Fetishaj, pra është padi rivendikimi dhe gjykata do të duhej të hetonte për origjinën e pronës së pretenduar. Bazuar në nenin 10 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar (*ligji nr. 7843/1994*), anëtarët e familjes Fetishaj e kanë regjistruar pronën e tyre përpara kërkuesit dhe në këto kushte ai duhej të kundërshtonte titullin e pronësisë, kontratën e shitblerjes dhe jo të paraqiste një padi të re për njohjen e kthimin e pasurisë. Sipas shkresës "Përgjigje" të datës 20.04.2018, ZRPP-ja ka sqaruar se kërkuesit i është njohur dhe kthyer më shumë truall se i takonte dhe se në vendimin nr. 1091/1994 të KKKP-së nuk është pasqyruar një pjesë e pasurisë së kërkuesit e kompensuar fizikisht në troje të tjera shtetërore, si dhe një pjesë është kompensuar për shpronësimin me VKM-në nr. 752/2013. Edhe eksperti i caktuar nga gjykata ka konkluduar për mundësinë e mbivendosjes së pronës së familjes Fetishaj me atë të pretenduar nga kërkuesi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

19. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", nenit 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik,

subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë dhe jurisprudencën e saj në këtë drejtim, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae*, të *shterimit të mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

21. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, i cili verifikohet në drejtim të natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt* në aspektet e *së drejtës së aksesit* dhe *asaj për t'u njoftuar*, *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit*, si dhe cenimin e *së drejtës së pronës private*, të garantuara përkatësisht nga nenet 42 dhe 41 të Kushtetutës.

22. Në drejtim të pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar*, kërkuesi ka parashtruar se nuk është njoftuar nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në datën 03.06.2025.

23. Gjykata vëren se e drejta për t'u njoftuar për gjykimin ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, ai të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes (*shih vendimet nr.7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë, së bashku me atë për të marrë pjesë në gjykim, u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se kjo e drejtë realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe ajo nuk konsiderohet e cenuar vetëm për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, për sa kohë që individi ka pasur

mundësinë që të paraqesë pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 10, datë 11.02.2026; nr. 23, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Referuar dispozitave procedurale civile që rregullojnë shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, të zbatueshme edhe në gjykimin administrativ, neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin paraprak të rekursit në dhomën e këshillimit, për të vlerësuar nëse ai plotëson kushtet e pranueshmërisë. Në rastin kur rekursi plotëson këto kushte, çështja kalon për shqyrtim gjyqësor, i cili, si rregull, zhvillohet në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, sipas nenit 482 të KPC-së, ose në seancë gjyqësore me praninë e palëve, sipas nenit 482/a të tij. Për këtë fazë të shqyrtimit, neni 482/a, pika 2, i KPC-së parashikon njoftimin e palëve për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në mjediset e Gjykatës së Lartë dhe në faqen e saj të internetit, si dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

25. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, si dhe të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, vëren se në rubrikën "*Çështje të shpallura për gjykim*", kategoria "*Çështje administrative*", nënrubrika "*Për shqyrtim në dhomë e këshillimit*", në datën 29.04.2025, është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit të datës 21.05.2025, ora dhe përbërja e trupit gjykues, ku bën pjesë edhe çështja e kërkuesit. Sekretaria gjyqësore e asaj gjykate, me *e-mail*-in e datës 30.04.2025, ka njoftuar përfaqësuesin e kërkuesit në adresën e tij elektronike për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit në datën 21.05.2025. Megjithatë, shqyrtimi i çështjeve të planifikuara për atë datë është shtyrë për më 27.05.2025 për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Në atë datë (27.05.2025) Kolegji Administrativ ka vendosur sërish shtyrjen e shqyrtimit të çështjeve për në datën 03.06.2025 dhe përfundimisht, pasi ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit, ka vendosur mospranimin e tij.

26. Për sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e paraqitur nga kërkuesi, i përfaqësuar nga avokati i zgjedhur prej tij. Përfaqësuesi i kërkuesit është njoftuar në adresën e tij elektronike për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të datës 21.05.2025, ndaj kërkuesi ka pasur mundësi që t'i paraqiste parashtrimet e tij në mbështetje të shkaqeve të rekursit që përpara zhvillimit të asaj seance. Në këto kushte, mosnjoftimi personalisht i kërkuesit/përfaqësuesit të tij për shtyrjen e shqyrtimit të rekursit në datat 27.05.2025 dhe 03.06.2025 nuk përbën, në vetvete, cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa kohë ai nuk ka argumentuar ose provuar se, për këtë shkak, është penguar të ushtrojë ndonjë të drejtë procedurale ose se i është shkaktuar ndonjë pasojë konkrete në të

drejtat e tij themelore. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar* është haptazi i pabazuar.

27. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit substancial, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* dhe *së drejtës së pronës private,* pretendime që për nga natyra e tyre janë të tilla që përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për sa u përket argumenteve në mbështetje të këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se, sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë zgjidhje shkaqeve të rekursit, megjithëse i është kërkuar edhe njësimi i praktikës për këtë situatë atipike kur shpërblimi për interes publik i jepet subjektit jopronar. Po sipas kërkuesit, pavarësisht se në rekurs ishin ngritur shkaqe që kishin të bënin me cenimin e së drejtës së pronës private, është vendosur mospranimin e tij pa u shqyrtuar ato në themel, ndërsa gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar se përse është parashkruar e drejta e ngritjes së padisë dhe përse çështja përbën "*gjë të gjykuar*", si dhe se përse të drejtën e shpërblimit të pasurisë së shpronësuar të kërkuesit e kanë përfituar subjekte të tjera jopronare. Po kështu, sipas kërkuesit, si pasojë e vendimeve të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, ka mbetur në fuqi situata juridike sipas së cilës shpërblimi për pjesën e pasurisë që kërkuesi pretendon se i përket atij si pronar u është njohur subjekteve të tjera. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, në mbështetje të këtyre pretendimeve, vlerëson t'i shqyrtojë ato në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. *Kërkuesi* ka pretenduar se gjykatat nuk kanë arsyetuar në vendimet e kundërshtuara se përse i është parashkruar e drejta e ngritjes së padisë, cilat janë afatet ligjore të tejkaluara, si dhe cilat janë dispozitat ligjore që e parashikojnë se kur fillon dhe kur mbaron afati i parashkrimit të padisë. Sipas kërkuesit, ato gjykata nuk kanë arsyetuar përse e kanë konsideruar "*gjë të gjykuar*" çështjen e kërkuesit edhe pse nuk ndodheshin përpara të njëjtave palë, të njëjtit objekt dhe shkak ligjor dhe të njëjtave fakte, si dhe nuk kanë arsyetuar as nëse konsiderohet "*gjë e gjykuar*" një vendim i cili nuk e ka zgjidhur çështjen në themel. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vijon kërkuesi, nuk ka arsyetuar se përse ai është trajtuar si subjekt i shpronësuar në një kohë që nuk ishte në listën e subjekteve të shpronësuara, pasi pasuria e tij mbivendosej me një pjesë të pronës së subjekteve që rezultonin në listën e subjekteve të

shpronësuara. Po ashtu, ai ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar qoftë edhe me një fjali të vetme se përse të drejtën e shpërblimit të pasurisë së shpronësuar të kërkuesit e kanë përfituar subjekte të tjera jopronare dhe përse ky përfitim i padrejtë i tyre nuk mund t'i kthehet pronarit të ligjshëm nëpërmjet zëvendësimit të subjekteve të shpronësuara.

29. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, ka prapësuar se vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë kanë përmbushur standardet kushtetuese të arsyetimit dhe ato, në tërësinë e tyre, paraqiten të rregullta në formë, si dhe nuk rezultojnë të kenë paqartësi në përmbajtje. Pjesët hyrëse, ato arsyetuese dhe dispozitivët e atyre vendimeve janë në unitet dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Po sipas këtij subjekti, arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese për këto lloj vendimesh.

30. *Subjekti i interesuar, Ministria e Punëve të Brendshme*, ka prapësuar se argumentet e kërkuesit janë të paarsyeshme dhe të pabazuara, pasi ajo, në cilësinë e ministrisë së linjës, ka ndjekur të gjitha fazat procedurale të parashikuara në ligj, si dhe ka identifikuar pasuritë e shpronësuara, duke u bazuar në të dhënat zyrtare të institucioneve shtetërore kompetente, përfshirë ZRPP-në. Për më tepër, sipas këtij subjekti, e gjithë procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM ka qenë objekt kontrolli gjyqësor dhe nuk është konstatuar asnjë shkelje e ligjit material ose procedural, ndërkohë që pronarët mund të paraqesin padi dhe të kundërshtojnë atë akt për vlerën e shpronësimit dhe çdo pretendim tjetër mes pronarëve ose subjekteve që kanë të drejta pronësie nuk zgjidhet me padi ndaj institucioneve shtetërore.

31. *Subjekti i interesuar, Bashkia e Tiranës*, ka prapësuar se me të drejtë gjykata e apelit ka arsyetuar se për të njëjtin objekt kërkesëpadie dhe të njëjtat palë ka pasur një vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë, duke u ndodhur kështu në kushtet e "*gjësë së gjykuar*".

32. *Subjektet e interesuara, anëtarë të familjes Fetishaj*, kanë prapësuar se kërkuesi nuk ka kundërshtuar asnjëherë origjinën e pasurisë së tyre, konkretisht kontratën e shitblerjes me të cilën ata janë bërë pronarë të pasurisë së pretenduar nga kërkuesi që në vitin 1953. Padia e ngritur nga kërkuesi është padi për njohjen dhe dorëzimin e pasurisë nga familja Fetishaj tek ai, pra është padi rivendikimi dhe gjykata do të duhej të hetonte mbi origjinën e pronës së pretenduar nga kërkuesi. Sipas këtyre subjekteve, bazuar në nenin 10 të ligjit nr. 7843/1994, anëtarët e familjes Fetishaj e kanë regjistruar pronën e tyre përpara kërkuesit, ndaj ai duhej të kundërshtonte titullin e pronësisë, kontratën e shitblerjes dhe jo të paraqiste një padi të re për njohjen e kthimin e pasurisë. Këto subjekte të interesuara kanë prapësuar se me shkresën "Përgjigje" të datës 20.04.2018, ZRPP-ja ka sqaruar se kërkuesit i është njohur dhe kthyer më shumë truall se i takonte dhe se në vendimin nr. 1091/1994 të KKKP-së nuk janë pasqyruar një

pjesë e pasurisë e kompensuar fizikisht në troje të tjera shtetërore dhe një pjesë është kompensuar për shpronësim me VKM-në nr. 752/2013. Edhe eksperti i caktuar nga gjykata ka konkluduar për mundësinë e mbivendosjes së pronës së familjes Fetishaj mbi pronën e pretenduar të kërkuesit.

33. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se është kompetencë e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, të analizojnë dhe të vlerësojnë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të vendosin për kalimin ose jo të çështjes për shqyrtim gjyqësor. Megjithatë, ushtrimi i kësaj kompetence i nënshtrohet kontrollit kushtetues kur vendimmarrja për mospranimin e rekursit vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 29.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, edhe pse detyrimi për garantimin e këtij standardi nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, ajo gjykatë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata ka theksuar se, nga pikëpamja kushtetuese, arsyetimi konsiderohet i mjaftueshëm kur u jep përgjigje pretendimeve thelbësore për zgjidhjen e çështjes, shpjegon lidhjen midis rrethanave të çështjes, ligjit të zbatueshëm dhe përfundimit të arritur, si dhe bën të mundur kontrollin e vendimmarrjes. Ky standard nuk kërkon që gjykata t'i përgjigjet në mënyrë të detajuar çdo argumenti të palëve, por kërkon që ajo të trajtojë ato pretendime që janë përcaktuese për zgjidhjen e çështjes dhe mungesa e përgjigjes ndaj të cilave mund ta bëjë vendimin të paqartë, kontradiktor ose haptazi të paarsyeshëm (*shih vendimin nr. 73, datë 16.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit *(shih vendimet nr. 85, datë 23.12.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë *(shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, vëren se me vendimin nr. 752/2013 Këshilli i Ministrave ka vendosur shpronësimin për interes publik të subjektit A.F. për sipërfaqen 60,8 m² dhe të bashkëpronarëve Fetishaj për sipërfaqen 165,3 m². Kërkuesi, duke pretenduar se një pjesë e pasurisë së tij mbivendosej me pronën e familjes Fetishaj, i është drejtuar gjykatës për njohjen dhe kthimin e sipërfaqes 647 m². Me vendimin e datës 22.09.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar pjesërisht padinë, duke vendosur njohjen dhe kthimin kërkuesit të sipërfaqes 439 m². Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 03.11.2015, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 10.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

38. Po kështu, kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative me padi me objekt ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 752/2013 (procesi i dytë për kundërshtimin e këtij akti), për sa u përket subjekteve përfituese të shpërblimit të shpronësimit (nga bashkëpronarët Fetishaj, Burreli, Kallushi, Koleci etj. dhe nga Arif Fetishaj në favor të kërkuesit në

bashkëpronësi), me pretendimin se shpërblimi i shpronësimit i takonte familjes Petrela si pronare e pasurive nr. 7/156, për sipërfaqen 149.3 m^2, në vlerën 3.902.253 lekë dhe nr. 7/155, për sipërfaqen 60.8 m^2, në vlerën 1.589.130 lekë. Në lidhje me këtë padi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5751 (5772), datë 01.12.2016, ka vendosur pranimin e saj, duke ndryshuar VKM-në nr. 752/2013 për sa i përket subjektit në favor të të cilit duhej dhënë shpërblimi i pronës dhe konkretisht: nga Arif Fetishaj në favor të familjes Petrela për sipërfaqen 60,8 m², në pasurinë nr. 7/155 dhe nga bashkëpronarët Fetishaj në favor të familjes Petrela për sipërfaqen 149,3 m², në pasurinë nr. 7/156. Gjatë këtij gjykimi, gjykata e shkallës së parë ka kërkuar kryerjen e një akti ekspertimi, nga i cili ka rezultuar se sipërfaqja 439 m² në pronësi të familjes Petrela mbivendosej me pronat e familjes Fetishaj. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se pronësia e familjes Petrela mbi këtë sipërfaqe provohej nga vendimi nr. 9031, datë 22.09.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndaj shpërblimi i pasurisë së shpronësuar që përfshihet në këtë sipërfaqe, i njohur me VKM-në objekt padie, i takon asaj familjeje.

39. Mbi ankimin e palës së paditur, gjykata e apelit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit, për shkak se padia ishte paraqitur përtej afateve ligjore dhe se çështja përbënte "*gjë të gjykuar*". Për sa i përket afatit, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi kishte marrë dijeni për VKM-në nr. 752/2013 minimalisht në muajin shkurt të vitit 2014, kur kishte vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe se nuk vërtetohej ndonjë shkak ligjor për pezullimin e afatit të së drejtës për ta kundërshtuar atë gjyqësisht. Për sa i përket "gjësë së gjykuar", ajo ka vlerësuar se padia kishte në thelb të njëjtin kërkim, të njëjtat palë të paditura dhe të njëjtin shkak me padinë e mëparshme, për të cilën ishte dhënë një vendim i formës së prerë. Sipas gjykatës së apelit, pretendimet e kërkuesit nuk përbënin shkaqe për ngritjen e një padie të re, për sa kohë legjislatori kishte parashikuar mundësinë e rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit faqet 13–15*).

40. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesit, ka vlerësuar se është detyrë e palës rekursuese të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural dhe përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi i kërkuesit nuk përmbante shkaqe nga ato të

parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, si dhe neni 480 i KPC-së, për rrjedhojë ka vendosur mospranimin e tij (*shih paragrafin 18-19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

41. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, konstaton se për kundërshtimin e VKM-së nr. 752/2013 kërkuesi ka vënë në lëvizje dy procese gjyqësore administrative, ndërkohë që ka vënë në lëvizje edhe procesin civil për njohjen dhe kthimin e pronës. Në procesin e parë administrativ kërkuesi ka kërkuar, ndër të tjera, edhe detyrimin e Beqir Fetishaj që ta njihte pronar për sipërfaqen 647 m², si dhe ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 752/2013 për përcaktimin e subjektit të shpronësuar dhe masën e shpërblimit. Pas dërgimit të çështjes për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në seancën e datës 30.06.2014 kërkuesi ka hequr dorë nga kërkimi për njohjen pronar (detyruar nga fakti se ai përbënte një kërkim të lidhur me një gjykim civil dhe jo administrativ), për të cilin është vendosur pushimi i gjykimit. Për pjesën tjetër të kërkimeve, që lidheshin me kundërshtimin e VKM-së nr. 752/2013, në atë gjykim është vendosur rrëzimi i padisë për mungesë të legjitimitetit aktiv të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk rezultonte pronar i pasurisë së shpronësuar. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 07.11.2014.

42. Ndërkohë, me padinë e datës 25.02.2014, kërkuesi kishte vënë në lëvizje paralelisht edhe procesin civil për njohjen dhe kthimin e pronës, në përfundim të të cilit, me vendimin e datës 22.09.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e kishte njohur pronar të sipërfaqes prej 439 m², vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e datës 03.11.2015. Pas këtij vendimi, me padinë e datës 08.02.2016, kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës administrative për ndryshimin e VKM-së nr. 752/2013 për sa u përket subjekteve në favor të të cilëve duhej dhënë shpërblimi i shpronësimit (procesi i dytë administrativ).

43. Gjykata konstaton se në procesin e parë administrativ kërkuesi ka hequr dorë vetëm nga kërkimi për njohjen pronar, ndërsa kërkimet për kundërshtimin e VKM-së nr. 752/2013 janë rrëzuar për mungesë të legjitimitetit aktiv, me arsyetimin se ai nuk rezultonte pronar i pasurisë së shpronësuar. Ndërkohë, vendimi civil i datës 22.09.2014, me të cilin kërkuesi ishte njohur pronar i sipërfaqes 439 m², është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e datës 03.11.2015, pas përfundimit të procesit të parë administrativ. Pavarësisht këtyre fakteve, në procesin e dytë administrativ gjykata e apelit, duke iu referuar vetëm afatit ligjor 30-ditor për kundërshtimin e aktit administrativ, nuk ka vlerësuar nëse njohja gjyqësore e së drejtës së pronësisë, pas përfundimit të procesit të parë administrativ, në të cilin padia ishte rrëzuar për mungesë të legjitimitetit aktiv, përbënte një rrethanë juridike të re me ndikim në përcaktimin e momentit nga i cili kërkuesi mund të ushtronte efektivisht të drejtën për kundërshtimin e aktit të shpronësimit në cilësinë e pronarit. Po kështu, ajo nuk ka dalluar

kërkimin për njohjen e pronësisë, për të cilin kërkuesi kishte hequr dorë në procesin e parë administrativ dhe që ishte shqyrtuar në procesin civil, nga kërkimet për kundërshtimin e VKM-së nr. 752/2013.

44. Gjykata, bazuar në sa më sipër, vlerëson se në rastin konkret çështja që vihet në diskutim, në thelb, ka të bëjë me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në procesin gjyqësor të kundërshtuar në drejtim të zbatueshmërisë së parimit të *gjësë së gjykuar* dhe pasojave të tij në atë gjykim. Parimi i gjësë së gjykuar, element i parimit të sigurisë juridike, përbën edhe element themelor të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ky parim nënkupton se vendimi gjyqësor i formës së prerë është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike, duke i dhënë asaj qartësi dhe siguri (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në procesin gjyqësor kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Ky parim përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës në pjesën arsyetuese të vendimit, për sa kohë ato lidhen me objektin e gjykimit (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në aspektin kushtetues, gjëja e gjykuar synon të garantojë që një konflikt i zgjidhur përfundimisht ndërmjet të njëjtave palë, me vendim gjyqësor të formës së prerë, të mos vihet sërish në diskutim.

45. Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit, gjatë shqyrtimit të padisë së dytë të kërkuesit për kundërshtimin e VKM-së nr. 752/2013, ndonëse ka vlerësuar se ndodhej përpara gjësë së gjykuar, në kuptim të nenit 451/a të KPC-së, pasi çështja ishte shqyrtuar më parë ndërmjet të njëjtave palë, me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor, nuk ka analizuar nëse vendimi i parë administrativ, me të cilin padia ishte rrëzuar për mungesë të legjitimitetit aktiv të kërkuesit, kishte zgjidhur përfundimisht konfliktin ndërmjet palëve lidhur me subjektin përfitues të shpërblimit të shpronësimit. Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka analizuar as ndikimin e vendimit civil të formës së prerë, me të cilin kërkuesi ishte njohur pronar i sipërfaqes prej 439 m², në raport me shkakun për të cilin ishte rrëzuar padia e parë administrative.

46. Po kështu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka lënë të pandryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe, për rrjedhojë, nuk ka korrigjuar interpretimin dhe zbatimin prej saj të nenit 451/a të KPC-së për ekzistencën e gjësë së gjykuar në rastin e kërkuesit. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur as për argumentin e kërkuesit se vendimi i parë administrativ, me të cilin padia

ishte rrëzuar për mungesë të legjitimitetit aktiv, nuk kishte zgjidhur përfundimisht konfliktin ndërmjet palëve, dhe as për efektet e vendimit civil të formës së prerë në këtë rast. Në këto rrethana, kërkonte përgjigje të posaçme argumenti i kërkuesit nëse vendimi civil i mëvonshëm, me të cilin ai ishte njohur pronar, përbënte një rrethanë të re juridike që ndikonte në identitetin e shkakut dhe të situatës faktike të dy gjykimeve administrative dhe, për rrjedhojë, në zbatueshmërinë e parimit të gjësë së gjykuar.

47. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se mangësitë e konstatuara në vendimin e gjykatës së apelit në drejtim të mungesës së arsyetimit për zbatimin e afatit ligjor për kundërshtimin e aktit administrativ dhe për ekzistencën e elementeve të gjësë së gjykuar nuk janë korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur për pretendimet e kërkuesit lidhur me efektet e vendimit civil në përcaktimin e momentit nga i cili ai mund të ushtronte të drejtën për të kundërshtuar aktin administrativ, as për subjektin të cilit i takonte shpërblimi i shpronësimit, edhe pse këto pretendime lidhen, në thelb, me të drejtën kushtetuese të pronës private. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, veçanërisht i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme, pasi ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta ushtruar këtë rol aktiv, duke garantuar, në radhë të parë, respektimin e standardeve kushtetuese në procesin gjyqësor dhe duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 25, datë 05.03.2026; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, i takonte Gjykatës së Lartë t'u jepte përgjigje të mjaftueshme dhe të shprehur argumenteve të kërkuesit, për sa kohë ato ishin përcaktuese për rezultatin e procesit gjyqësor dhe kishin ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk përfshiheshin në ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje argumenteve me natyrë kushtetuese të kërkuesit që lidheshin me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar dhe efektet e vendimit civil të formës së prerë, ka tejkaluar kufijtë e diskrecionit të lejuar nga pikëpamja kushtetuese në ushtrimin e funksionit filtrues, duke cenuar, për rrjedhojë, të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e aksesit substancial në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, me pasoja edhe për të drejtën e pronës private të kërkuesit, e cila, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Mungesa e kësaj përgjigjeje, në rrethanat kur padia e parë administrative ishte rrëzuar për mungesë të legjitimitetit aktiv, ndërsa gjykimi i dytë administrativ ishte pushuar për shkak të afatit ligjor dhe gjësë së gjykuar, ka bërë që, si rezultat

i efektit të kombinuar të këtyre vendimmarrjeve, pretendimi i kërkuesit për subjektin përfitues të shpërblimit të shpronësimit të mos marrë një zgjidhje përfundimtare në themel.

48. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial në gjykatë* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të bazuara, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së pronës, sipas arsyetimit të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2375, datë 03.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.09.2026

Shpallur më 09.11. 2026